



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr. 34 / .Prot.
58

Tiranë, më 30/11/2018

MIRATOI

BUJAR LESKAJ

KRYETAR

PLANI I QENDRUESHMERISE

2018-2020

1. Një vështrim mbi situatën aktuale

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të detyrimit kushtetues për të informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, në shtatë vitet e fundit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ngritjes së kapaciteteve institucionale.

Kjo qasje ambicioze përputhet tërësisht me vizionin e institucionit, i cili synon të jetë një institucion profesional i besueshëm që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe subjektet e audituara.

Në përmbushje të objektivit të parë strategjik të Zhvillimit Institucional të KLSH 2013-2017 „Zhvillimi i kapacitetit institucional-Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatorë të KLSH-së në përputhje me ISSAI dhe praktikat e mira evropiane” në 27 nëntor të vitit 2014 u miratua ligji organik i KLSH nr. 154/2014 “ *Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit* ”, i cili është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe praktikat më të mira evropiane.

Ligji i ri, i cili i jep KLSH-së të drejtën për të zgjeruar diapazonin e auditimeve, duke kryer përveç auditimeve tradicionale edhe auditime performance dhe auditime të teknologjisë së informacionit, kërkon përveç rritjes së kapaciteteve institucionale dhe modernizimin e KLSH dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve për krijimin e një trupe audituesish të cilët kryejnë auditime cilësore.

Me synim përfitimin e eksperiencës më të mirë që ofrojnë SAI-et evropiane, KLSH në vitin 2014 aplikoi dhe u bë përfitues i financimit të projektit të binjakëzimit nga Bashkimi Evropian, në vlerën 2.1 milion euro. Në bashkëpunim me ekspertët e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë dhe ekspertë të SAI-eve të Holandës, Estonisë dhe Portugalisë, drejtues dhe auditues të KLSH punuan ngushtësisht për ngritjen e kapaciteteve institucionale të KLSH-së.

1.1. Projekti i Binjakëzimit

Objektivi i kryesor i projektit që nisi të implementohej në 16 mars 2016 dhe përfundoi në datën 11 korrik 2018 ishte forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri. Me qëllim modernizimin e institucionit projekti ishte i ndarë në tre komponentë, të cilat ishin:

Komponenti 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për auditimet;

Komponenti 2: Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve raportuese;

Komponenti 3: Forcimi i kapacitetit institucional të KLSH-së dhe përmirësimi i ndikimit të auditimeve të kryera nga ky institucion.

Përmirësimi i kuadrit ligjor të auditimit ishte objektivi kryesor që synonte përmirësimin e akteve ligjore ekzistuese, miratimin e dokumenteve dhe akteve të tjera që synonin përmirësimin e aktivitetit të auditimit. Gjatë misioneve të kryera, janë analizuar legjislacioni primar dhe sekondar i KLSH.

Dokumentet e dorëzuara nga ekspertët për komponentin e parë janë :

- Analiza e kuadrit ligjor të KLSH përkundrejt standardeve të të INTOSAI-t dhe standardeve të tjera ndërkombëtare;
- Analiza e kuadrit ligjor të KLSH përkundrejt modeleve të shteteve anëtare të BE-së;
- Analiza e zbatimit të ligjit dhe identifikimi i pengesave të mundshme për zbatimin e ndryshimeve;
- Udhëzim për zbatimin e ligjit të ri të KLSH-së në fusha specifike;
- Plani i Veprimit për hartimin e akteve nënligjore;
- Analiza e rishikimit të rregullores së brendshme dhe propozimet për ndryshimin, në përputhje me ligjin e ri të KLSH-së dhe qasjen e re për auditimet e përputhshmërisë, auditimet financiare dhe auditimet e performancës;
- Analiza e akteve rregullative për marrëdhëniet e KLSH-së me Parlamentin dhe praktikat konkrete në marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve;
- Draft- udhëzues për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin, si dhe plani e masat për zbatimin e këtij udhëzimi;
- Analiza e kuadrit ligjor dhe praktikat e KLSH-së për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Komponeni i Dytë – *Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe të kapacitetit të auditimit – përbën numrin më të madh të aktiviteteve të zhvilluara gjatë projektit.*

Në këtë kontekst, ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë punuan sëbashku me stafin e KLSH-së në drejtimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i metodologjisë së auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit;
- Rishikimi dhe përditësimi i manualit të auditimit për luftën kundër korrupsionit dhe gjithashtu trajnimi i audituesve në këtë fushë;
- Manuali mbi sigurimin dhe kontrollin e cilësisë dhe listat për këtë proces auditimi;
- Draftimi i planit vjetor të auditimeve të përputhshmërisë për 2017-ën, bazuar në analizën e riskut me asistencën e ekspertëve polakë;
- Zhvillimi i manualit të Auditimit të IT;
- Modulet e auditimit të IT në trajnimet standarde për audituesit e KLSH-së;

- Krijimi i Helpdesk-ut;
- Rishikimi i auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë;
- Fjalori i terminologjisë së auditimit;
- Plani i Qëndrueshmërisë.

Lidhur me komponentin e tretë “Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të KLSH-së në rezultatet e auditimit”, u zhvilluan disa misione të cilat rishikuan aktivitetin e KLSH-së. Këto misione kishin për qëllim përmirësime në:

- Ndryshime të planifikuara në menaxhim;
- Shqyrtimi i situatës së burimeve njerëzore të KLSH-së dhe draftimi i politikave të burimeve njerëzore;
- Shqyrtimi i politikave të komunikimit të KLSH-së me publikun dhe palët e interesit dhe përkufizimi i detyrave dhe mjeteve për strategjinë e komunikimit;
- Komunikimi i brendshëm dhe përcaktimi i nevojave për komunikim të brendshëm dhe zhvillim;
- Shqyrtimi i procedurave aktuale të auditimit të lidhura me garantimin e transparencës, me synim rritjen e besimit të opinionit publik ndaj institucionit.

Pjesë e projektit ishte gjithashtu zhvillimi me asistencën e ekspertëve polakë, kroatë dhe holandezë i tre auditimeve të përputhshmërisë dhe financiare, një auditimi të teknologjisë së informacionit dhe katër auditimeve të performancës.

Audituesit e KLSH-së në gjashtë vizita studimore patën mundësinë të fitojnë eksperiencë nga kolegët e tyre, polakë, kroatë dhe holandezë sa i përket fazave të zhvillimit të auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë, të auditimeve të përformancës, procedurat që lidhen me luftën ndaj korrupsionit dhe mashtrimit, procedurat për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, politikat për komunikimin e rezultateve të auditimit tek publiku dhe përmirësimin e transparencës, si dhe politikat e burimeve njerëzore.

Në projektin që u implementua për 28 muaj u zhvilluan rreth 107 misione dhe ecuria e projektit ishte subjekt i nëntë takime të komitetit drejtues. Rreth 100 auditues dhe drejtues të KLSH-së u përfshinë në takimet dhe trajnime me ekspertët polakë, kroatë dhe holandez.

Dokumenti nr. 16/44, datë 30 qershor 2017 dhe dokumenti nr 920, datë 1 gusht 2018, në të cilat janë përfshirë 231 rekomandime të dala nga misionet e zhvilluara në kuadër të implementimit të projektit, janë miratuar nga Kryetari dhe i janë përcjellë për zbatim strukturave përgjegjëse.

Projekti i binjakëzimit është monitoruar dhe vlerësuar edhe nga strukturat e Komisionit Evropian.

Kriteret e vlerësimit të përdorura për të monitoruar dhe vlerësuar ecurinë e implementimit të projektit ishin:

- Rëndësia;
- Efektiviteti;
- Efiçenca;
- Qëndrueshmëria.

Nga shqyrtimi i dokumenteve bazë misioni i monitorimit rekomandoi:

- Pas përfundimit të projektit, KLSH-ja duhet të identifikoj produktet nga projekti i binjakëzimit dhe të theksojë impaktin e projektit në sektorin e auditimit të jashtëm.
- KLSH-ja dhe SAI i Polonisë duhet të hartojnë një plan qëndrueshmërie, në të cilin të përfshihen rekomandimet e lëna nga ekspertët, veprimet që duhen ndërmarë dhe dokumentet që duhen amenduar/miratuara, si dhe periudhën kohore të implementimit të këtyre veprimeve.
- KLSH-ja duke u konsultuar me palët e interesit të rishikojë Strategjinë e Zhvillimit Institucional për vitet 2018-2022 në mënyrë që të identifikon qartasi një numër objektivash të orientuara drejt rezultate.

1.2. Situata në KLSH

Qëndrueshmërisë së rezultateve të Projektit dhe ndikimit afatgjatë të këtyre rezultateve në veprimtarinë institucionale dhe audituese të KLSH-së iu kushtua një rëndësi e veçantë që prej fillimit të implementimit të tij, pasi rishikimi dhe amendimi i disa prej dokumenteve bazë të institucionit, hartimi i politikave efikase dhe moderne të burimeve njerëzore, qasjet inovative nëpërmjet përdorimit të mjeteve të reja të komunikimit dhe trajnimit i vazhdueshëm i stafit do të siguronin zhvillimin dhe modernizimin institucional të KLSH.

Vizioni i KLSH-së është të ndërtojë një institucion suprem të auditimit të krahasueshëm me nivelin evropian dhe global. Zbatimi i Projektit të Binjakëzimit ishte të mbështeste KLSH-në në arritjen e këtij qëllimi.

KLSH ka miratuara Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2018-2022. Në një shtrirje të gjerë, dokumenti bazohet mbi rezultatet e Projektit të Binjakëzimit - qëllimet dhe objektivat strategjike lidhen drejtpërsëdrejti me përvojat dhe rezultatet e Projektit.

Qëllimet strategjike të KLSH-së	Fushat e përfshira nga qëllimi strategjik që adresuan nga Projekti i Binjakëzimit
<p>Qëllimi 1: Rritja e ndikimit të punës së auditimit nëpërmjet 6 E-ve (ekonomi, eficiencë, efektivitet, etikë, mjedis dhe energji).</p>	<p>Përmirësimi i metodologjisë së auditimit dhe përshtatja e tij me standardet ISSAI, si dhe me praktikat më të mira të BE-së, duke përfshirë auditimin e TI., auditimin e performancës, auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, si dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.</p>
<p>Qëllimi 2: Optimizmi i kapaciteteve profesionale të auditimit, i procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.</p>	<p>Auditimi i bazuar në risk, kultura e të mësuarit gjatë gjithë jetës, sistemi i arsimit profesional, politikat e burimeve njerëzore, masat kundër korrupsionit.</p>
<p>Qëllimi 3: Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.</p>	<p>Bashkëpunimi me Parlamentin, bashkëpunimi me partnerët e KLSH-së si dhe një strategji komunikimi, të gjitha për të rritur ndikimin e auditimeve tek palët e interesuara dhe tek publiku i gjerë.</p>

Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të KLSH-së duhet të monitorohet dhe të rishikohet çdo vit. Kjo është planifikuar të arrihet përmes rishikimeve vjetore të progresit për secilin Objektiv Strategjik dhe objektivat të tjera të përcaktuara në Planin e Veprimit që shoqëron Strategjinë. Për këtë janë identifikuar treguesit e performancës për matjen e progresit të implementimit të Strategjisë së Zhvillimit.

Është e rëndësishme të theksohet se janë përcaktuar strukturat përkatëse për monitorimin dhe matjen e progresit të performancës, të cilat janë Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera brenda KLSH.

2. Treguesit e qëndrueshmërisë së Projektit

Qëllimi kryesor i projektit ishte përmirësimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm, bazuar në praktikat më të mira të BE-së dhe standardeve të INTOSAI-t. Implementimi i këtij projekti në Kontrollin e Lartë të Shtetit u krye edhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i nenit 90 të Marrëveshjes së Stabilizimi-Asociimit me Bashkimin Evropian, i cili parashikon bashkëpunimin midis palëve me fokus në fushat prioritare që lidhen me Acquis të BE-së në fushën e financave publike, kontrollit (PIFC) dhe auditimit të jashtëm. Në këtë kontekst, palët duhet të bashkëpunojnë sidomos për të zhvilluar sisteme efçiente PIFC dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar nga bashkësia ndërkombëtare, si dhe me praktikat më të mira të BE-së.

Duke mbajtur parasysh objektivat e Projektit, treguesit e qëndrueshmërisë së tij konsistojnë në indikatorët që lidhen me:

- Numrin e rekomandimeve të zbatuara;
- Auditimet e KLSH-së të kryera në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe me praktikat më të mira të BE-së;
- Përmbushjen e detyrimeve nga KLSH si organ i auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, në përputhje me Deklaratën e Limës, duke kontribuar kështu në përdorimin efektiv, efçient, transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve publike.

3. Gjendja e zbatimit të rekomandimeve të Projektit deri në mes të muajit qershor 2018

Implementimit të rekomandimeve të lëna nga ekspertët, KLSH i ka dhënë një rëndësi të veçantë duke miratuar dy matrica në të cilat janë përmbledhur rekomandimet, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe raportimin dhe afatet kohore për implementimin e tyre. Në fund të qershorit 2018, ekspertët polakë që punuan për hartimin e planit të qëndrueshmërisë konstatuan se nga KLSH ishin implementuar 67 rekomandime nga numri i përgjithshëm prej 161¹.

¹ Shifrat e cituara më sipër, grafikët dhe tabelat janë marrë nga raporti i misionit 3.1.3.13, „Draft-Plani i Qëndrueshmërisë” të hartuar nga ekspertët polakë.

Tabela 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve të Projektit për seicilin komponent në fund të qershorit 2018

Statusi	Komponenti 1	Komponenti 2	Komponenti 3	Totali
Të pushuara	1	0	0	1
Të pashqyrtuar	3	7	6	16
Të planifikuara	3	5	0	8
Në progres	4	35	30	69
Të zbatuara	16	10	41	67
Totali	27	57	77	161
Përqindja e rekomandimeve të zbatuarave përkundrejt totalit	59%	18%	53%	42%

142 rekomandime të Projektit janë mbuluar nga Objektivat Strategjikë të Planit të Zhvillimit të KLSH-së për vitet 2018-2020. Ato do të jenë subjekt i monitorimit dhe vlerësimit në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së.

Statusi	Nr. i rekomandimeve	% mbi totalin	Rekomandimet e adresuara nga Plani Strategjik i Zhvillimit të KLSH 2018-2020
Të pushuara	1	0,6%	0
Të pashqyrtuara	16	9,9%	16
Të planifikuara për t'u zbatuar	8	5,0%	6
Në progres	69	42,9%	66
Të zbatuara	67	41,6%	54
Totali	161	100%	142

Projekti ka patur një impakt të konsiderueshëm në veprimtarinë e institucionit të KLSH-së. Me qëllimin e implementimit të eksperiencës së përfitur nga projektit dhe pas analizimit të dokumenteve të propozuara nga ekspertet dhe rekomandimet e tyre, KLSH-ja tashmë ka aprovuar dhe vënë në dispozicion të audituesve dhe palëve të interesit dokumentet e mëposhtme:

- Vendimi i Kryetarit nr. 16/34, datë 31.07.2017 “Për miratimin e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019”;

- Vendimi i Kryetarit nr. 107, datë 08.08.2017 “ Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit”;
- Vendimi i Kryetarit nr. 228, datë 31.12.2017 “Për dokumentin e politikave të burimeve njerëzore “;
- Vendimi i Kryetarit të KLSH-së nr. 1353, datë 31.12.2017 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022;
- Vendimi i Kryetarit nr. 79, date 30.06.2018 “Për miratimin e Metodologjisë së hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit”;
- Vendimi i Kryetarit nr.80, datë 30.06.2018 “Për miratimin e Manualit Udhëzues për Zbulimin e Korrupsionit dhe mashtrimit Financiar në Auditim “;
- Vendimi i Kryetarit nr. 81, date 30.06.2018 “Për miratimin e Udhëzuesit për Institucionalizimin e Marrëdhënieve me Parlamentin;

Dokumenti nr. 16/44, dt. 30 qershor 2017 dhe dokumenti nr 920, datë 1 gusht 2018 në të cilat janë përfshirë 231 rekomandime² të dala nga misionet e zhvilluara në kuadër të implementimit, janë miratuar nga Kryetari dhe i janë përcjellë për zbatim strukturave përgjegjëse.

4. Faktorët e qëndrueshmërisë së Projektit

KLSH në bashkëpunim dhe në konsultime të vazhdueshme me ekspertët polakë identifikoi faktorët që janë të domosdoshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të Projektit dhe, në një perspektivë afatgjatë, forcimin e mëtejshëm të auditimit të jashtëm në Shqipëri.

<i>Nr.</i>	<i>Faktori i qëndrueshmërisë</i>	<i>Objektivi i qëndrueshmërisë</i>
1	Angazhim i fuqishëm i drejtuesve të lartë të KLSH-së Elementi kyç i suksesit të zbatimit të qëndrueshëm të rezultateve të Projektit është përfshirja individuale e drejtuesve të lartë të KLSH-së në nisjen dhe përfundimin e veprimeve përkatëse që duhen ndërmarrë.	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e vazhdueshme nga drejtuesit e lartë të KLSH-së në arritjen e qëndrueshmërisë së rezultateve të Projektit
2	Qëndrueshmëria organizative e institucionit të KLSH Për të implementuar rekomandimet e projektit në një fushë të caktuar, përgjegjësinë duhet ta ketë gjithmonë një drejtues, përgjegjës për këtë fushë. Kjo qasje do të forcohet nëse KLSH-ja do të synojë vazhdimësi të menaxhimit të fushës specifike. Me synimin e arritjes së rezultateve të qëndrueshme	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi efektiv i rezultateve të Projektit në KLSH • Përgjegjësia për zbatimin e rezultateve të Projektit

² Ky numër përbën numrin total të rekomandimeve të përfshira në dy matricat e miratuara nga Kryetari i KLSH për periudhën mars 2016- maj 2018

	<p>të Projektit është e rëndësishme që KLSH të emërojë/përcaktojë monitoruesit/raportuesit e projektit, të cilët do të promovojnë, monitorojnë dhe mbështesin implementimin për një periudhë afat gjatë të produkteve të projektit. Monitoruesit/raportuesit duhet të jenë plotësisht përgjegjës për arritjen e rezultateve të pritshme. Ata duhet të sigurojnë që rezultatet e projektit të merren parasysh gjatë hartimit/ndryshimit të procedurave, dokumenteve strategjike, praktikave dhe përditësimit të rregulloreve. Monitoruesit/raportuesit duhet të mbajnë pozicione drejtuese në KLSH.</p>	
3	<p>Burimet në dispozicion Mungesa e burimeve pengon qëndrueshmërinë e Projektit. Disponimi në kohë i burimeve financiare, njerëzore dhe teknike siguron zbatimin e rezultateve të Projektit dhe prioritizimin e tyre në aktivitetet e KLSH-së.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Burime të përshtatshme për të vazhduar zbatimin e rezultateve të Projektit
4	<p>Rezultatet e Projektit përfshihen në procedurat operacionale Vetëm përfshirja e suksesshme e rezultateve të Projektit në sistemet dhe procedurat ekzistuese duke u siguruar që ato të përbëjnë një pjesë të aktiviteteve të zakonshme (rutinë) të KLSH, siguron që Projekti të jetë i qëndrueshëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e Projektit të përfshira në procedurat operacionale të KLSH
5	<p>Mbështetja menaxheriale Drejtuesit e nivelit të mesëm në KLSH luajnë një rol ndërlidhës mes drejtuesve të lartë të KLSH dhe stafit. Ata duhet të mbështesin idetë dhe qasjet e reja në metodat e punës. Rrjedhimisht, ata janë agjentë të ndryshimit në KLSH, të gatshëm për të marrë përsipër risqe për zbatimin e produkteve të reja, qasjeve etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatohet në praktikë lidhja midis vendim-marrjes strategjike dhe zbatimit të vendimeve.
6	<p>Përfshirja aktive e stafit të KLSH-së Qëndrueshmëria e rezultateve të Projektit do të varet nga përdorimi i tyre i përditshëm nga stafi i KLSH-së. Është e rëndësishme që stafi të kuptojë qëllimin e ndryshimeve të paraqitura dhe rolin e tyre në zbatimin e rezultateve të Projektit. Në të njëjtën kohë, stafi duhet të ndihet i vlerësuar për kontributin e tij në procesin e ndryshimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje nga stafi i KLSH-së për të siguruar që rezultatet e Projektit të përdoren në punën e tyre të përditshme
7	<p>Mbështetje e ekspertëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekspertët të ofrojnë

	Zbatimi i rezultateve të Projektit mund të hasë probleme, të cilat mund të kërkojnë mbështetje nga ekspertët. Për të zbutur këtë risk, KLSH duhet të jetë gati për të vënë në dispozicion ekspertët e brendshëm dhe të jashtëm për të këshilluar ata që janë përgjegjës për zbatimin e rezultateve të Projektit.	mbështetje nëse lindin probleme, duke qenë të disponueshëm, si ekspertët e brendshëm dhe ata të jashtëm
8	Informimi dhe komunikimi Monitorimi i progresit duhet të mbulojë si të dhënat cilësore dhe ato sasiore që do të përdoren për të ndjekur procesin e zbatimit. Rishikimi i rregullt dhe vlerësimi i rezultateve të Projektit janë të rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmërinë e Projektit. Ata mund të tregojnë problemet në zbatimin e tij dhe nevojën për korrigjime, si dhe të ndihmojnë fleksibilitetin.	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna të disponueshme për përparimin në zbatimin e Projektit • Informacion mbi rezultatet e arritura kundrejt objektivave të vendosura
9	Fleksibiliteti në zbatimin e rezultateve të Projektit Mjedisi në të cilin funksionojnë institucionet supreme të auditimit, i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme. Gjatë implementimit të Projektit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rishikimit të rregullt të relevancës së Projektit dhe përditësimit të mundshëm të tyre.	<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e Projektit të përditësuara në përputhje me ndryshimin e mjedisit të KLSH-së
10	Efektiviteti i dukshëm Vizioni i KLSH-së është të ndërtojë një institucion suprem të auditimit, i cili të jetë i krahasueshëm me nivelin evropian dhe global. Zbatimi i Projektit të Binjakëzimit ishte të mbështeste KLSH-në në arritjen e këtij qëllimi. Në këtë mënyrë, KLSH-ja e forcon imazhin e tij si një institucion modern, i cili e bazon aktivitetin auditues në standardet ndërkombëtare dhe në praktikat më të mira të BE-së.	<ul style="list-style-type: none"> • Dialog me partnerët e brendshëm dhe të jashtëm të KLSH mbi proceset e ndërmarra nga KLSH, me qëllim forcimin e auditimit të jashtëm në Shqipëri

5. Infrastruktura e qëndrueshmërisë së Projektit në KLSH

Analiza e faktorëve të qëndrueshmërisë është baza për hartimin e veprimeve që do të ndërmerren për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të Projektit.

5.1. Përcaktimi i qartë i përgjegjësiave

1. **Kryetari i KLSH-së** është mbështetësi më kryesor i projektit. Ai drejton institucionin me synimin e përmbushjes së qëllimeve të Projektit, duke kontribuar kështu në misionin dhe vizionin e institucionit. Ndikimi i vazhdueshëm, mbështetës dhe nxitës duhet të ruhet

edhe për periudhën në vijimësi, sepse është parakusht për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të Projektit.

2. Për të arritur këtë, Kryetari i KLSH-së përcakton në rolin e **monitoruesit/ raportuesit** mbi ecurinë e implementimit të rekomandimeve dhe qëndrueshmërinë e projektit. Me synimin e sigurimit të rezultateve të qëndrueshme në zbatimin e rekomandimeve të projektit monitoruesit/raportuesit ngarkohen me detyrat e mëposhtme:
 - Mbështetjen e Kryetarit në gjenerimin e aftësive organizative dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të rezultateve të Projektit.
 - Mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të progresit.

Angazhimi i monitoruesve që njëkohësisht do të jenë dhe raportues për qëndrueshmërinë e projektit është një element vendimtar për të siguruar qëndrueshmërinë e Projektit. Me këtë detyrë ngarkohen Drejtorët e Përgjithshëm dhe Sekretari i Përgjithshëm.

3. Monitoruesit që njëkohësisht do të jenë dhe raportues për qëndrueshmërinë e projektit i kryejnë detyrat e tyre bazuar në punën e **Agjentëve të Ndryshimit**, të cilët i zbatojnë rekomandimet e Projektit në nivel operacional. Agjentët e ndryshimit ngarkohen me përgjegjësitë e mëposhtme:
 - të iniciojnë dhe kryejnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të rezultateve të Projektit;
 - të monitorojnë dhe vlerësojnë aktivitetet që çojnë drejt suksesit;
 - të identifikojnë risqet dhe të ndërmarrin veprimet korrigjuese.

Për kryerjen e këtij misioni të rëndësishëm, Agjentë të Ndryshimit, ngarkohen Drejtuesit e Departamenteve dhe Drejtuesit e Drejtorive.

Në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij dokumenti gjendet lista e personave përgjegjës për implementimin e planit të qëndrueshmërisë.

4. Për të siguruar ekspertizën përkatëse në mbështetje të drejtuesve dhe stafit të KLSH-së në procesin e vënies në zbatim të rekomandimeve të Projektit do të caktohet **një rrjet ekspertësh të brendshëm** (kryeauditues dhe auditues) për të ofruar mbështetje në nivel operacional (përshkruar në pikën 5.4.).

Afati kohor: Pas përfundimit të projektit dhe në vijimësi

5.2. Përcaktimi i burimeve

Zbatimi praktik i rezultateve të Projektit përbën një sfidë për KLSH-në, kryesisht në lidhje me angazhimin e burimeve njerëzore, ngarkesën e punës, riorganizimin strukturor dhe burimet

teknike, si dhe trajnimin. Pavarësisht nga përfundimi i aktiviteteve të Projektit, në punën e përditshme të auditimit dhe funksionimit të KLSH burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare do vihen në dispozicion për zbatimin e rezultateve të këtij Projekti.

Afati kohor: Pas përfundimit të aktiviteteve të projektit dhe në vijimësi.

5.3. Integrimi i Projektit brenda aktivitetit të KLSH-së

Projekti mund të vlerësohet i suksesshëm dhe rezultatet e tij janë të qëndrueshme, vetëm nëse produktet e tij bëhen pjesë integrale e veprimtarisë së përditshme të KLSH.

Zbatimi i Projektit përfshinte një sërë rezultatesh konkrete për KLSH-në, të cilat parashikonin ndryshimet e nevojshme në strukturën e brendshme të KLSH-së dhe transferimin e njohurive, të cilat do të përdoren drejtpërdrejt nga stafi pas përfundimit të Projektit. Kjo përfshinte:

- Rishikimin, propozimin dhe zbatimin e strukturës së brendshme të KLSH-së, duke reflektuar kërkesat e ligjit të ri për KLSH;
- **Materiale me shkrim**, që përfshijnë, ndër të tjera, rekomandime për ndryshime ligjore, dokumente strategjike, udhëzime për procedurat e brendshme, programe trajnimi manualet e rishikuara për auditimin financiar, të përputhshmërisë si dhe auditimin e performancës, një modul trajnimi për auditimet e TI-së, politikat e burimeve njerëzore, politikat e komunikimit, terminologjinë e auditimit për administratën publike në Shqipëri etj.
- **Mjetet mbështetëse të auditimit të TI-së** (krijimi i tryezës së ndihmës për auditimin);
- Koncepti për përmirësimin e raportit të auditimit, duke e kthyer në një raport më miqësor me lexuesin;
- **Trajnimin e trajnerëve** për të siguruar shpërndarjen e mëtejshme të njohurive dhe praktikave të grumbulluara gjatë Projektit dhe pas përfundimit të tij;
- **Tetë auditime pilot**, që tregojnë se si zbatohen metodologjitë e auditimit në praktikë (katër auditime të performancës, tre auditime financiare dhe të përputhshmërisë, auditimi pilot i TI-së për një nga sistemet tipike të TI në administratën shqiptare);
- **Aktivitetet trajnuese** (p.sh.: auditimi kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit, qasja e auditimit mbi bazën e riskut për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, trajnimin për procesin vjetor të planifikimit, trajnimin mbi aspektet e miratuara të auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë, trajnimin mbi metodologjinë e auditimit të performancës, Seminar mbi marrëdhëniet me Parlamentin, etj).
- **Vizita studimore** - pesë vizita në SAI të shteteve anëtare të BE.

Procesi i integritit të rezultateve të Projektit në procedurat operative të KLSH duhet të vazhdojë. Zbatimi i metodave të reja duhet të paraprihet nga aktivitetet përgatitore të stafit, si trajnimet dhe prezantimet.

Afati kohor: Pas përfundimit të Projektit dhe në vijimësi.

5.4. Sigurimi i mbështetjes për veprimet e mëtejshme

Gjatë procesit të zbatimit të rezultateve të Projektit, stafi i KLSH-së duhet të mbështetet nga ekspertët e brendshëm, të cilët kanë një njohuri të thelluara të fushave përkatëse. Detyrat e tyre janë:

- Të këshillojnë stafit;
- Të nxisin zgjidhje të reja, mjete dhe metodologji;
- Të rrisin vetëdijen dhe edukimin e stafit në aplikimin në praktikë të produkteve dhe procedurave të reja.

Ekspertët e brendshëm që ofrojnë mbështetje operationale do të jenë anëtarët e stafit të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese, auditime pilot ose vizita studimore, në kuadër të Projektit.

Për një ekspertizë më të thelluar KLSH do të krijojë rrjetin e ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë institucionet profesionale dhe arsimore shqiptare, si dhe anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare të auditimit publik.

Bashkësia ndërkombëtare e audituesve publikë përbën një platformë jo vetëm për mbështetjen e kolegëve, por edhe për diskutimin e zhvillimit të auditimit publik, si dhe veprime të përbashkëta që synojnë të përballojnë sfidat dhe pritshmëritë ndaj institucioneve të larta të auditimit.

Anëtarësimi në grupet e ndryshme të punës dhe në task-forcat e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t krijon mundësinë për të thelluar ekspertizën në një fushë të caktuar të auditimit dhe njëkohësisht, të punohet për një auditim më të mirë të jashtëm në Shqipëri.

Afati kohor: Pas përfundimit të aktiviteteve të projektit dhe në vazhdimësi

5.5. Monitorimi i zbatimit të rezultateve të projektit

Implementimi konkret i rezultateve të Projektit do të monitorohet kryesisht nga Agjentët e Ndryshimit dhe duhet të përfshijë:

- një sistem monitorimi në kohë reale;
- vlerësimin e risqeve;
- paralajmërimet e sistemit në rast të vonesave ose ndryshimeve;
- raportimin në nivele të përshtatshme – tek Monitoruesit që njëkohësisht do të jenë dhe raportues për qëndrueshmërinë e projektit (Drejtorët e Përgjithshëm dhe Sekretari i Përgjithshëm) dhe/ose tek Kryetari i KLSH-së.

KLSH tashmë ka përgatitur dhe miratuar dy Matrica të Rekomandimeve të Projektit, me anë të së cilave synohet implementimi sipas afateve kohore i këtyre rekomandimeve. Këto matrica do t'u shërbejnë agjentëve të ndryshimit për monitorimin e rezultateve të arritura, nëpërmjet kontrolleve të herëpashershme.

Afati kohor: Aktivitet i përhershëm, që do të vazhdojë pas përfundimit të aktiviteteve të Projektit.

5.6. Vlerësimi i progresit të arritur

Qëllimi parësor i vlerësimit, përveç të kuptuarit të iniciativave të mëparshme ose ekzistuese, është që të mundësojë reflektim, identifikimin e risqeve dhe të ndihmojë në identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të ardhmen. Kjo do të ndihmojë në marrjen e vendimeve strategjike, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Projektit, të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri.

Vlerësimi do të kryhet duke shqyrtuar se sa dhe si është kryer implementimi i rekomandimeve të Projektit. Kriteret e vlerësimit do të jenë:

- Numri i rekomandimeve të zbatuara dhe vlerësimi nëse zbatimi i tyre ka çuar në përmirësimin e praktikave të punës të stafit të KLSH;
- Rishikimi i dokumenteve dhe procedurave bazuar në propozimet e bëra nga ekspertët gjatë implementimit të projektit.

Në hartimin e vlerësimit për qëndrueshmërinë e Projektit, monitoruesit/raportuesit do të bazohen edhe në raportet e monitorimit të zbatimit të matricave të rekomandimit të hartuara nga Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Kjo drejtori po punon edhe për hartimin e matricës së tretë në të cilën do të përfshihen rekomandimet të cilat nuk janë implementuar ende dhe do të shtohen edhe veprimet konkrete që lidhen me zbatimin e planit të qëndrueshmërisë.

Afati kohor: Çdo gjashtë muaj.

Për të siguruar qëndrueshmërinë e produkteve dhe rekomandimeve të Projektit, KLSH në kuadrin e vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet Kornizës së Matjes së Performancës (SAI PMF), do të shprehet edhe për rezultatet e implementimit të Projektit.

5.7. Komunikimi

Vizioni i KLSH-së është të ndërtojë një institucion suprem auditimi, të krahasueshëm me nivelin evropian dhe global dhe objektivi i implementimit të Projektit të Binjakëzimit ishte të mbështeste KLSH-në në arritjen e këtij qëllimi. Komunikimi i rezultateve dhe ndryshimeve që ka pësuar aktiviteti i institucionit të KLSH pas implementimit të projektit shërben për t'i bërë të njohur publikut dhe palëve të interesit etapat nëpërmjet të cilave ka kaluar dhe synon të arrijë modernizimin e KLSH. Një komunikim efektiv dhe i hapur duke përdorur median dhe mjetet moderne të komunikimit, i shërben forcimit të imazhit të KLSH-së si një institucion modern, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të BE-së. Komunikimi eficient është një aspekt i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e Projektit, pasi ai inkurajon mbështetjen dhe përfshirjen e partnerëve të brendshëm dhe të jashtëm.

Komunikimi i brendshëm

Njohje e stafit të KLSH me rekomandimet dhe produktet e Projektit përbën një aspekt tejet të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e Projektit. Për këtë një rol primar merr komunikimi i brendshëm i cili siguron që çdo punonjës merr:

- Informacionin e duhur praktik gjatë përdorimit të metodave dhe mjeteve të reja - për të lehtësuar përdorimin e tyre;
- Informacionin mbi aktivitetet e planifikuara - për të siguruar që stafi është i vetëdijshëm për pritshmëritë;
- Informacionin mbi progresin në arritjen e objektivave të projektit.

Parakusht për këtë është sigurimi i një komunikimi të hapur ndërmjet drejtuesve të KLSH-së dhe stafit. Për këtë Intraneti i KLSH do të shërbejë përcjelljes së informacionit konkret për implementimin e projektit në një nënfaqe të veçantë. Ngarkohen monitoruesit, që njëkohësisht do të jenë dhe raportues për qëndrueshmërinë e projektit, të përcjellin informacionin e duhur pranë strukturës përkatëse të ngarkuar me përditësimin e informacionit në intranet.

Komunikimi i jashtëm

Në kuadër të aktiviteteve të Projektit, KLSH ka zhvilluar kanalet e përmirësuara të komunikimit me Parlamentin dhe publikun, si dhe ka miratuar Strategjinë e saj të Komunikimit, që mbulon komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm me partnerët e KLSH-së.

Është e rëndësishme që kanalet e jashtme të komunikimit të përdoren për të shpërndarë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe audituese të KLSH-së.

Afati kohor: Pas përfundimit të projektit dhe në vazhdim.

5.8. Përditësimi i rregullt i rezultateve të projektit

Konteksti kombëtar, evropian dhe global në të cilin funksionojnë institucionet e larta të auditimit po ndryshon. Globalizimi, paqëndrueshmëria financiare dhe politike, pritshmëritë në rritje ndaj efektivitetit të auditimit publik ndikojnë gjithashtu në KLSH. Për të mbetur një institucion i rëndësishëm që perceptohet si një kontribues efektiv në menaxhimin financiar publik, në qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien publike, KLSH do të vazhdojë të monitorojë ndryshimet në mjedisin e tij të punës. Kjo përfshin:

- Identifikimin e ndikimeve të mundshëm në vlefshmërinë e rezultateve të Projektit;
- Përfshirjen e ndryshimeve të dobishme në procesin e zbatimit të rezultateve të Projektit;
- Përfshirjen e korrigjimeve në procedurat dhe praktikave të përdorura nga stafi i KLSH-së;
- Përditësimin dhe pasurimin e njohurive rreth praktikave më të mira në auditimin publik;
- Vlerësimin nëse rezultatet e arritura kontribuojnë në objektivat e KLSH-së.

Afati kohor: Çdo gjashtë muaj

Shtojca 1

Strukturat përgjegjëse për monitorimin, raportimin dhe implementimin e Planit të Qëndrueshmërisë

1. Me detyrën e Monitoruesit/ raportuesit të ecurisë së implementimit të rekomandimeve dhe qëndrueshmërinë e projektit ngarkohen:
 - Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano
 - Drejtori i Përgjithshëm, znj. Lindita Milo
 - Drejtori i Përgjithshëm, znj. Manjola Naço
2. Me detyrën e Agjentëve të Ndryshimit ngarkohen:
 - Z. Azmi Stringa, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
 - Z. Bashkim Arizaj, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
 - Z. Rinaldo Muça, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Performances
 - Z. Qemal Shehu, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
 - Z. Bajram Lamaj, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
 - Z. Kozma Kondakçiu, Drejtor, Departamenti i Auditimit të IT
 - Znj. Yllka Pulashi, Drejtor, Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

- Z. Ermal Yzeiraj, Drejtor, Departamenti Juridik
- Znj. Albana Gjinopulli, Drejtor, Departamenti i Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit
- Z. Xhaferr Xhoxhaj, Drejtor, Drejtorja e Auditimit të Investimeve të Huaja
- Z. Gjovalin Preçi, Drejtor, Drejtorja e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve
- Z. Artur Hasanbelliu, Drejtor, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm
- Znj. Irena Islami, Drejtor, Drejtorja e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Znj. Edlira Sako, Drejtor, Drejtorja e Burimeve Njerëzore

3. Rrjeti i ekspertëve të brendshëm do të përbëhet nga:

- Z. Klarenc Xhaferaj Kryeauditues
- Znj. Aulona Jonuzi Kryeaudituese
- Znj. Valbona Gaxha Kryeaudituese
- Z. Muhamet Kavaja, Kryeauditues
- Znj. Mariola Lleshi Kryeaudituese
- Z. Aulent Guri, Kryeauditues
- Z. Niko Nako Kryeauditues
- Z. Alush Zaçe, Kryeauditues
- Znj. Lolita Baholli, Kryeaudituese
- Z. Fatmir Iljazi, Kryeauditues
- Z. Alfred Çako Kryeauditues
- Znj. Brunilda Zeneli, Kryeaudituese
- Z. Bexhet Zeqiri Kryeauditues
- Z. Koço Sokoli, Kryeauditues
- Z. Qeram Cibaku, Përgjegjës Sektori
- Z. Aldo Kita, Përgjegjës Sektori
- Znj. Miranda Haxhia, Audituese e Lartë
- Z. Alfonc Gabili, Auditues i Lartë
- Znj. Elira Cukalla, Audituese e Lartë
- Z. Benard Haka, Auditues i Lartë
- Z. Emiljano Doko, Jurist
- Zj. Alma Shehu, Audituese e I^{-rë}
- Z. Rigels Guzi, Auditues i I^{-rë}
- Znj. Joniada Goçaj, Audituese e I^{-rë}
- Znj. Miranda Berdo, Audituese e I^{-rë}
- Z. Dorel Balliu, Auditues i I^{-rë}
- Znj. Ina Sokoli, Audituese e I^{-rë}